



**Federata e Peshkatarëve Sportiv Recreativ e Kosovës
Savez Sportsko Recreativnih Ribolovaca Kosova
Kosovo Federation of Sports Recreational Fishermen**

RREGULLORE NR. 7 / 2024 PËR TRANSFERIN, GARUSËVE, STATUSI I TYRE

Prishtinë korrik 2024

Në bazë të nenit 19 të Statutit të **Federata e Peshkatarëve Sportiv Recreativ e Kosovës** në mbledhjen e mbajtur më..... Bordi i FPSRK-së propozon rregullore:

Draft

RREGULLORE NR. 6 / 2024 PËR TRANSFERIN, GARUSËVE, STATUSI I TYRE

I. DISPOZITAT E PËRERGJITHSHME

Neni 1

Me rregulloren për regjistrim (tutje referuar si “**Rregullorja**”) rregullohet procedura dhe mënyra e regjistrimit të klubeve, shoqatave, lojtarëve, trajnerëve, gjyqtarëve, kontrolluesve dhe personave të tjerë (kryetarëve, përfaqësuesve, mjekëve, teknikëve mjekësorë, etj. të klubeve/shoqatave), mënyra e kalimit të garuesve prej klubit/ shoqatës në / shoqate/klub dhe e drejta për pjesëmarrje në gara të FPSRK-së, e drejta për paraqitje në gara të nënshtetasve të huaj për klube anëtare të FPSRK-së , e drejta për pjesëmarrje të lojtarëve të Kosovës nëpër klube të jashtme, si dhe Libri i regjistrimit dhe mënyra e udhëheqjes.

II. PARAQITJA DHE REGJISTRIMI I KLUBEVE

Neni 2

Për tu anëtarësuar një klub/shoqatë i FPSRK-së për meshkuj apo femra në FPSRK-së , duhet ti plotësojë këto kushte (të plotësohet Formulari nr.1):

1. Ta paraqet Kërkesën për anëtarësim (regjistrim) në FPSRK-së ;
2. Kërkesës t’ia bashkëngjitë procesverbalin e kuvendit të vet konstituiv, me regjistrin e emrave të anëtarëve të Kryesisë së Klubit/shoqatës;
3. Kërkesës t’ia bashkëngjitë kopjen e Statutit të klubit/shoqatës, i cili nuk duhet të jetë në kundërshtim me Statutin dhe aktet të tjera normative të FPSRK-së ;
4. Të ketë regjistrimin si OJQ pranë organit gjegjës të komunal, si dhe vendimin mbi regjistrim pranë organit kompetent komunal (Drejtorisë së Sportit) si klub publik apo privat;
5. Të paguaj shumën për regjistrimin e klubeve/shoqatave, lartësinë e së cilës e cakton Bordi i FPSRK-së, me vendim të posaçëm;
6. Të regjistrojë në FPSRK-së jo më pakë se 5 garues;

Neni 3

1. Klubet që plotësojnë kushtet nga nenet 2 dhe 3 të kësaj Rregulloreje, do të bëhen anëtarë të FPSRK-së në ditën e regjistrimit të tyre sipas dispozitave gjegjëse fitojnë të drejtën të inkuadrohen në gara përkatëse që organizohen nga FPSRK-së.
2. Lidhur me kërkesat e kompletuara për Regjistrimin e klubeve/shoqatave, në afat prej 8 ditësh nga data e dorëzimit të tyre, duhet të vendos Komisioni për Regjistrimin e lojtarëve dhe klubeve/shoqatave. Dhe pas regjistrimit FPSRK-së është e obliguar që t'i lëshoj vendimin klubit/shoqatës në formë të shkruar (Formulari nr.2)

Neni 4

1. Klubi/shoqata është i obliguar që çdo vit të ripërtërinë licencimin - anëtarësimin, dhe atë para fillimit të edicionit të ri të garave.
2. Me rastin e ripërtëritjes së licencës 25 € anëtarësisë klubi është i obliguar që të përmbushë pagesën në shumë prej 25 € sipas vendimit të Bordit të FPSRK-së.
3. Zyra e FPSRK-së bënë vërtetimin e licencës – anëtarësisë konform nenit 2 dhe 8 të Rregullores mbi regjistrimin e klubeve/shoqatave,, lojtarëve statusi dhe transferin e tyre.

Neni 5

Çdo regjistrim në Regjistrin e klubeve/shoqatave, të FPSRK-së , duhet të ketë edhe vulën e FPSRK-së.

Neni 6

1. Anëtarësia në Federatë konsiderohet e pezulluar për të gjitha klubet të cilat nuk marrin pjesë në garat e organizuara për stinorin aktual, apo të cilat nuk kanë marrë pjesë në gara përgjatë tërë stinorit paraprak në rastet kur mbledhja e Kuvendit mbahet gjatë pauzës në mes stinorëve. Në rast të tillë, delegatët e klubeve/shoqatave, në Kuvendin e Federatës mund të jenë pjesëmarrës në cilësinë e vëzhguesit dhe pa të drejtë vote. Anëtarësia konsideruar e ndërprerë për të gjitha klubeve/shoqatave, që nuk marrin pjesë në dy vite garuese.
2. Klubi pushon të jetë anëtarë i FPSRK-së, në bazë të vendimit të Kuvendit të Klubit, apo sipas dispozitave të akteve normative të FPSRK-së që e parashohin këtë:
 - a. Largimin nga Federata;
 - b. Shuarja e veprimtarisë; dhe
 - c. Ndalesës së punës dhe veprimtarisë.

III. PARAQITJA DHE REGJISTRIMI I GARUSËVE

Neni 7

Anëtarë të klubit/shoqatës janë:

- garuesit /garueset,
- personat zyrtarë dhe

- të tjerë

Neni 8

1. Çdo klub/shoqatë është i obliguar që një herë në vjet, të ripërtërije licencën – anëtarësinë për anëtarët e saj (Formulari nr. 3, 3.1 dhe 3.2).
2. Me rastin e pagesës së anëtarësisë, shuma e të cilës caktohet nga Bordi i FPSRK-së, vërtetimi i anëtarësisë dhe licencimi bëhet nga zyra e Federatës.
3. Të gjithë anëtarët e FPSRK-së, gjyqtarët, trajnerët, dhe të tjerë obligues të regjistruar në FPSRK-së janë të obliguar të posedojnë librezat e anëtarësisë dhe rregullisht të i përmbushin obligimet e anëtarësisë. Shuma e pagesës së anëtarësisë për një vit garues përcaktohet në kuvendin e federatës:
 - a. Libreza për /garues
 - b. Licencimi për garues /garuese
 - c. Libreza e trajnerit
 - d. Anëtarësia e trajnerit
 - e. Libreza e gjyqtarit, vëzhguesit dhe kontrolluesit
 - f. Anëtarësia e gjyqtarit, vëzhguesit dhe kontrolluesit
 - g. Për librezat e tjera
 - h. Për anëtarësitë tjera
 - i. Licencimi – anëtarësimi i klubit/shoqatës

Neni 9

Çdo regjistrim dhe licencim i anëtarëve të Federatës duhet të vërtetohet me vulën e FPSRK-së.

Neni 10

1. Garuesi i cili me dëshirën e vet e zgjedh klubin, regjistrimin për të mund ta bëjë prej moshës 10-vjeçare, nën kushte të parapara sipas kësaj rregulloreje, me ç'rast pranon obligimet, të drejtat dhe detyrat e parapara me akte normative të FPSRK-së.
2. Për garuesin nën moshën 18 vjeç, bashkëngjitur dokumentacionit për regjistrim, duhet të jetë edhe pëlqimi i njërit prej prindërve apo kujdestarit (Plotësohet Formulari nr.5).

Neni 11

Regjistrimin e garuesve të klubeve/shoqatave, të gjitha ligave të Kosovës e bën Komisioni për regjistrim, i emëruar nga Bordi i FPSRK-së.

Neni 12

1. Asnjë garues nuk mund të regjistrohet për dy apo më shumë klube në të njëjtën kohë.
2. Anëtarësia e garuesit për një klub dokumentohet në bazë të regjistrimit paraprak.

3. Garuesi i cili në afat kalimtar e nënshkruan fletëregjistrimin për dy apo më shumë klube, me dokumentacion komplet apo jo komplet, e humb të drejtën e kalimit nga klubi amë dhe do të mbetet anëtar i tij deri në afatin e ardhshëm kalimtar dhe për këtë sanksionohet në bazë të dispozitave të Rregullores disiplinore të FPSRK-së .

Neni 13

1. Përjashtim nga dispozitat e nenit paraprak mund të bëhet për:
2. Garuesit e klubit anëtar të Kampionatit , i cili është më i ri se 21 vjeç dhe për garuesit e Kampionatit të femrave, e cila është më e re se 20 vjeçe, me pëlqim paraprak të klubeve dhe garuesit apo garuesit që mund të regjistrohet edhe për një klub, por që bën gara në rang më të ulët.
3. Në këtë mënyrë mund të regjistrohet garuesi apo garuesja për dy klube dhe ta fitojë të drejtën e pjesëmarrjes në gara gjatë një viti garues për dy klube, përveç në garat për kupë, për të cilat mund të paraqitet vetëm për një klub.
4. Në këtë mënyrë të regjistrimit të dyfishtë për një klub mund të regjistrohen më së shumti 2 garuesë-e.
5. Afati i fundit për regjistrim të dyfishtë është përfundimi javës së kampionatit në të dy konkurrencat.
6. Garuesi i regjistruar me regjistrim të dyfishtë për dy klube , mund të garoj në një xhiro dy klubet por jo në të njëjtën ditë.

Neni 14

1. Garuesit të cilët e kanë fletë statusin e lojtarit të lirë (formulari nr. 5.2), mund të regjistrohen për klubin e ri edhe jashtë afatit kalimtar, deri në përfundimin e kampionatit në të gjitha konkurrencat.
2. Garuesit të cilët nuk kanë kontrata me klubet, dhe në afatin kalimtar nuk aplikojnë për kalim në ndonjërin klub apo status të lojtarit të lirë (formulari nr. 5.2), mund të regjistrohen edhe pas afatit kalimtar vetëm me fletë lëshimin e klubit në të cilin ka pasur paraqitje në ndeshjen e fundit kampionale, për këtë përveç formularit nr. 5.2 duhet bërë edhe pagesën në shumë prej 20 euro në xhirollogarinë rrjedhëse të **FPSRK-së** .

Neni 15

1. Për Garuesit i cili për herë të parë regjistrohet, klubi i cili dëshiron ta regjistrojë është i obliguar që Komisionit për regjistrim t'ia paraqesë këtë dokumentacion (formulari nr.5):
 - a. fletëkërkesën e garuesin , së cilës duhet bashkëngjitur edhe kërkesën e klubit në formë të shkruar në dy kopje;
 - b. deklaratën e me shkrim në dy kopje se në dy vjetët e fundit garues nuk ka qenë i regjistruar për asnjë klub;
 - c. certifikatën e lindjes;
 - d. dy fotografi të madhësisë 3x4 cm, jo më të vjetra se gjashtë muaj;
 - e. vërtetimin mbi pagesën e bërë prej 5 euro në xhirollogari gjegjëse të **FPSRK-së**;

- f. për garuesin që kanë luajtur në botën e jashtme është e obligueshme internacional transfer certifikatë - pëlqimi i federatës ku ka luajtur më parë dhe vërtetimi mbi pagesën e bërë prej 30 euro në xhirollogarinë gjegjëse të Federatës .

Neni 16

1. Për garuesin që kalon prej klubit në klub, klubi i cili dëshiron ta bëjë regjistrimin, Komisionit për regjistrim duhet parashtruar këtë dokumentacion (Formularin nr 5.1):
 - a. fletëkërkesën e lojtarit, së cilës duhet bashkëngjitur edhe kërkesën e klubit për regjistrim, të shtypura në dy kopje;
 - b. flete pëlqimin prej klubit paraprak apo vendimin e organit gjegjës të atij klubi se garuesin është i lirë për ta ndërruar klubin apo vendimin e organit të shkallës së dytë të për FPSRK-së shkëputjen e kontratës me kërkesë të garuesin , të cilën klubi paraprak nuk ia ka dhënë në afatin e rregullt, librezën e anëtarësisë nga klubi paraprak, në të cilën duhet të jetë e evidencuar data dhe koha e çregjistrimit nga klubi paraprak me një fotografi të madhësisë 3x4 cm, jo më të vjetër së gjashtë muaj;
 - c. certifikatën e lindjes;
 - d. vërtetimin mbi pagesën e bërë prej 5 euro në xhirollogarinë e Federate-së.

Neni 17

1. Për garuesin me regjistrim të dyfishtë të, klubi i cili dëshiron ta regjistrojë garuesin në këtë mënyrë (klubi i dytë) duhet që Komisionit për regjistrim t'ia dorëzojë këtë dokumentacion (Formulari A):
 - a. fletëkërkesën e garuesin, së cilës duhet bashkëngjitur edhe kërkesën e klubit për regjistrim, të shtypura në dy kopje;
 - b. kontratën në mes të dy klubeve për të drejtën e regjistrimit të dyfishtë;
 - c. certifikatën e lindjes;
 - d. një fotografi të madhësisë 3x4 cm, jo më të vjetër së gjashtë muaj, vërtetimin mbi pagesën e bërë prej 15 euro në xhirollogarinë të FPSRK-së për regjistrim të dyfishtë.

Neni 18

Për garuesin kosovarë që kalojnë nga ndonjë klub i jashtëm në ndonjë klub të Kosovës, Komisionit për regjistrim duhet parashtruar këtë dokumentacion (Formulari B):

- fletëkërkesën e lojtarit me kërkesë të klubit për regjistrim në formë të shkruar në dy kopje,
- pëlqimin e federatës gjegjëse që i takon klubit nga i cili vjen garuesi,
- fletëçregjistrimin nga klubi paraprak me dëshmi se nuk ka kurrfarë obligimi ndaj tij,
- dy fotografi të madhësisë 3x4 cm, që nuk është më e vjetër se gjashtë muaj,
- vërtetimin mbi pagesën e bërë prej 15 euro në xhirollogarinë gjegjëse të FPSRK-së për regjistrim,

- certifikatën e lindjes
- vërtetimin mbi pagesën e bërë prej 75 euro në xhirollogarinë të për garuesin që vijnë nga klubi i ndonjë federate të jashtme në klub kosovar.

Neni 19

1. Afati kalimtar i rregullt zgjat prej 1 dhjetori deri më 31 dhjetor të vitit aktual dhe ndahet në katër (4) periudha:
 - 1.1. periudha e parë: **prej 1 deri 10 dhjetor** të vitit aktual kur peshkatari sportist i dorëzon kërkesën klubit për lejim,
 - 1.2. periudha e dytë: **deri më 18 dhjetor** të vitit aktual në të cilën klubit të cilit i është bërë kërkesa për lejim është i obliguar që të përgjigjet në kërkesën e peshkatari sportist,
 - 1.3. Periudha e tretë: **prej 18 deri më 25 dhjetor** të vitit aktual, kur klubi medoemos duhet të paraqesë në Komisionit për regjistrim të peshkatari sportist të Federatës për miratimin kalimit të peshkatarit sportist nga klubi në klub,
 - 1.4. Periudha e katërt: **prej 25 deri më 31 dhjetor** të vitit aktual, kur Komisioni për regjistrim të peshkatarit sportist është i obliguar të lëshojë një vendim për miratimin ose refuzimin e kërkesës për kalimin e peshkatarit sportist nga klubi në klub.
 2. Çdo parashtrim që ka të bëjë me këtë nen duhet ti dorëzohet personalisht atij të cilit i drejtohet ose me postën me kthim me të cilën tregohet që dërgesa është bërë, ose në mënyrë personale me nënshkrim të pranuesit (personit zyrtar).
 3. Afatet kohore do të llogariten në ditë.
 4. Afati nuk përfshin ditën e dorëzimit kur është kryer dërgesa, por për fillim të afatit merret dita e nesërme.
 5. Nëse dita e fundit e afatit bie në një festë publike apo ditë e diel, afati skadon në ditën e ardhshme.
 6. Peshkatari sportist mund të bëjë kalimin prej klubit në klub peshkatari sportist jashtë afatit kalimtar në rastet e mëposhtme:
 - me fshirjen e klubit peshkatari sportist nga regjistri zyrtar i organit kompetent dhe zgjat 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas përfundimit të ditës së parë të vendimit të organit kompetent;
 - me përfundimin e procedurës disiplinore dhe zgjatë në përputhje me nenin 4 të kësaj rregulloreje, përveç se për fillim të afatit llogaritet kalimi i ditës së parë të përfundimit të procedurës disiplinore;
 - me masat disiplinore të kryera të pjesëmarrjes në gara në kuptim të nenit 4 të kësaj rregulloreje, përveç se për fillim të afatit llogaritet kalimi i ditës së parë të përfundimit të masave disiplinore;
 - skadimi i periudhës ligjore të pushimit të lehonisë dhe zgjatë në përputhje me nenin 4 të kësaj rregulloreje, përveç se për fillim të afatit llogaritet kalimi i ditës së parë të përfundimit të periudhës ligjore të pushimit të lehonisë.
- Në qoftë se dita e fundit e afatit bie në ditën e diel apo në një festë publike ose ndonjë ditë tjetër kur klubi apo nuk punon, afati kalon në ditën e ardhshme. Kjo vlen për të gjitha dispozitat e kësaj rregulloreje në të cilat u referohemi afateve.

Neni 20

1. Peshkatari sportist që dëshiron të ndërroj klubin në afatin kalimtar duhet të paraqesë një kërkesë me shkrim për lëshim klubit në të cilin është anëtar. Kërkesa i referohet klubit amë,

kurse kopja e kërkesës komisionit të regjistrimit të FPSRK me postë të regjistruar ose personalisht me verifikim dhe nënshkrim.

2. Përmbajtjen dhe formën e kërkesës e zgjedhë vet parashtruesi, përveç se është i obliguar që në kërkesë të shënoj klubin në të cilin kalon si dhe të dhënat personale: emrin, mbiemrin, adresën dhe vendin e banimit.

3. Si datë e aplikimit, llogaritet data e vulës postare të deponuar në postë apo nga data kur ia dorëzon kërkesën personit të autorizuar të klubit amë.

4. Brenda afatit kalimtar peshkatari sportist mund të dorëzoj kërkesë për kalim vetëm në një klub. Po kështu, peshkatari sportist mund ta tërheqë kërkesën e tij për të kaluar në një klub të ri, në periudhën prej 01.-10. dhjetor të vitit aktual. Njoftimin me shkrim të tërheqjes së kërkesës për lëshim të i dorëzon klubit amë, klubit të ri dhe Komisionit për regjistrim të peshkatari sportist të FPSRK-së me postë të regjistruar ose personalisht me verifikim dhe nënshkrim.

5. Si datë e tërheqjes së kërkesës, llogaritet data e vulës postare të deponuar në postë apo nga data kur ia dorëzon kërkesën personit të autorizuar të klubit amë apo klubit të ri.

6. Peshkatari sportist, i cili afatin kalimtar të njëjtë nënshkruan formularin e aplikimit ose kontratë për dy ose më shumë klube do të nënshtrohet përgjegjësisë disiplinore dhe mbetet i regjistruar për klubin me të cilin ai është regjistruar para afatit kalimtar.

7. Kur klubi amë pranon kërkesën për dhënien e lëshimit, ai është i detyruar t'i përgjigjet kërkesës brenda afatit të parashikuar në nenin 4. të paragrafit 2 të kësaj rregulloreje. Nëse të gjitha kërkesat e parashikuara në këtë Rregullore janë plotësuar që klubi amë të lëshojë fletë lëshimin, kurse në të kundërtën ai do të refuzojë dhënien e fletëlëshimit, me arsyet dhe të drejtën e ankimit.

Neni 21

1. Flet lëshimin ose vendim për refuzimin e kërkesës klubi amë është i obliguar ta dorëzojë, vetëm me postë rekomanduese ose personalisht me verifikim dhe nënshkrim:

1.1. parashtruesit të kërkesës peshkatari sportist ;

1.2. klubit të cilit peshkatari sportist në kërkesë e ka quajtur si klub i ri (klubin ku do të kalojë);

1.3. Komisionit të regjistrimit të FPSRK-së .

2. Formulari i flet lëshimit është pjesë integrale të kësaj rregulloreje.

3. Si datë e dhënies së fletë lëshimit llogaritet data e vulës postare e depozitimit të regjistruar ose data e verifikimit kur i dorëzohet , peshkatari sportist klubit të ri dhe Komisionit të regjistrimit të peshkatari sportist të FPSRK-së .

4. Klubi amë mund të refuzojë kërkesën për dhënie të flet lëshimit në rastet e mëposhtme:

4.1. peshkatari sportist i cili është nën kontratë;

4.2. peshkatari sportist ndaj të cilit zhvillohen masat disiplinore ose masat që rrjedhin të sanksioneve disiplinore;

4.3. peshkatari sportist i cili në kërkesë nuk ka saktësuar klubin në të cilin kalon dhe të dhënat personale;

4.4. peshkatari sportist që është në pushim ligjor të lehonisë.

5. Nëse klubi amë nuk i përgjigjet kërkesës për dhënien e lëshimit të peshkatari sportist për brenda afatit të parashikuar në kuptim të nenit 3, paragrafit 1, nën-paragrafit 1.2 të kësaj

rregulloreje do të konsiderohet se peshkatari sportist ka marrë miratimin për të kaluar në një klub të ri.

6. peshkatari sportist që merr pëlqimin në kuptim të paragrafit të mësipërm të këtij neni do të regjistrohet për një klub të ri. Klubi nga i cili është peshkatari sportist nuk ka të drejtë në kompensim.

Neni 22

1. Sportisti i cili fare nuk ka marrë pjesë në garat së paku 365 ditë (një vit) nga dita e pjesëmarrjes së fundit, me paraqitjen e kërkesës për kalim në klub të ri fiton të drejtën e regjistrimit për klubin e ri në aspektin e nenit 3 ose ndri mit të klubit sipas kësaj rregulloreje.

2. Sportisti i cili fare nuk ka marrë pjesë në garat së paku 365 ditë (një vit) mundet gjithashtu të regjistrohet për një klub të ri në kuptim të regjistrimit të parë.

3. Periudha e jo garuese nuk llogaritet:

3.1. kur Sportisti ka një kontratë të vlefshme;

3.2. Sportistit ndaj të cilit zhvillohen masat disiplinore ose masat që rrjedhin të sanksioneve disiplinore;

3.3. Sportisti që është në pushim ligjor të lehonisë.

Neni 23

1. Klubi amë nuk mund ta suspendon Sportistin as të fillojë procedurën disiplinore kundër Sportistit në rastet e mëposhtme:

1.1. kur Sportistiti mbaron kontrata;

1.2. pas aplikimit të kërkesës për kalim të Sportistit në një klub të ri;

1.3. kur Sportisti është në pushim ligjor të lehonisë;

1.4. pas skadimit të ditës 365 të mospjesëmarrjes në gara.

Neni 24

1. Klubi i ri i parashtron kërkesë për miratimin e kalimit të Sportistit të rinj Komisionit për regjistrim të FPSRK-së.

2. Kërkesa është në rregull, në qoftë se ajo është paraqit në përputhje me nenin 20 të paragrafit 1 pika 3 të kësaj rregulloreje. Kërkesa duhet të paraqitet personalisht dhe dorëzimi duhet konfirmuar nga personi i autorizuar në FPSRK-së ose me postë me pranimin e kthimit të dëshmuar se kërkesa ishte dorëzuar.

3. Kërkesa duhet të shoqërohet me:

3.1. Listën e Sportistit të ri për të cilët kërkohet miratimi i kalimit;

3.2. Një fotokopje me formular të aplikimit të nënshkruar nga Sportisti për klubin e ri (formulari origjinal dhe 2 foto të bashkangjitur për komisionin për regjistrim të FRK, pas miratimit nga ana e Komisionit);

3.3. Flet lëshimi me ose pa sqarim;

3.4. Një vërtetim i bankës si dëshmi e pagesës së kompensimit;

3.5. Një kopje të kërkesës për lëshim dhe pranimin postar origjinal të dërgesës së regjistruar.

- 3.6. Konfirmimi i klubit amë për pjesëmarrjen e fundit apo deklaratën personale të sportistit, në bazë të materialit të plotë dhe përgjegjësisë personale, për sportistët të cilët nuk kanë garuar për klubin amë për të paktën 365 ditë;
- 3.7. Vendimin e komisionit për regjistrim të Federatës për vlerësimin e përmbushjes së detyrimeve të ndërsjella të palëve kontraktuese;
- 3.8. Vendimin e autoriteteve kompetente për të hequr nga regjistri i autoritetit kompetent.
4. Si datë parashtrimit të kërkesës llogaritet data e vulën postare të depozitimit në postë të regjistruar ose datën e verifikimit pas pranimit nga komisioni i regjistrimit të Sportistit .
5. Kur Komisioni për regjistrim i FPSRK-së pranon një kërkesë të rregullt për miratimin e kalimit të Sportistit në klub të ri, është e nevojshme për të marrë një vendim për miratimin e kërkesës për kalim, në kuptim të nenit 19 të kësaj rregulloreje.
6. Komisioni për regjistrim i FPSRK-së, vendimin mbi aprovimin e kërkesës për kalim, e dorëzon vetëm me postë ose email: klubit të ri, klubit amë dhe sportistit.
7. Nëse Sportisti nuk është i regjistruar për klubin e ri sportisti, prej 30 ditë nga data e marrjes së vendimit, mbetet Sportisti i paregjistruar për atë sezon ose anëtar i klubit amë.

Neni 25

1. Kontrata mund ta realizojnë Sportisti dhe klubi dhe kështu të përcaktojë të drejtat dhe obligimet përkatëse të klubit dhe sportistit. Kontrata do të nënshkruhet nga personi i autorizuar i klubit dhe Sportisti nga ana tjetër.
2. Nëse në kohën e nënshkrimit të kontratës Sportisti nuk është i moshës madhore, klubi duhet të nënshkruajë një kontratë me prindin ose kujdestarin e tij.
3. Kontrata përfshin pjesën kryesore dhe aneksin e kontratës.
4. Kontrata bazë duhet të përmbajë elementet e mëposhtme:
 - 4.1. të dhënave personale të palëve;
 - 4.2. kohëzgjatjen e kontratës;
 - 4.3. obligimet e Sportistit në aspektin e ekzekutimit të detyrave në pajtim me aktet normative të klubit dhe Federatës sportit e Kosovës;
 - 4.4. mënyra dhe kushtet në të cilat ata mund të ndërpresin kontratën.
5. Pjesa kryesore e kontratës duhet të jenë të vërtetuar nga ana e personit të autorizuar të FPSRK-së, dhe në rast të kontestit, kontrata e vlefshme duhet të jetë vetëm ajo e dorëzuar në FPSRK-së, kurse bëhet në 3 (tre) kopje identike, prej të cilave një (1) kopje i përket sportistit, klubit, dhe një .
6. Aneksi i kontratës është pjesë e marrëveshjes bazë dhe ka karakterin e një sekreti afarist dhe duhet të jetë më afër për të rregulluar marrëdhëniet e Sportistit dhe klubit. Aneksi i kontratës do t'i bashkëngjitet Komisionit për regjistrim të FPSRK-së në rast të një mosmarrëveshje ndërmjet Sportistit dhe klubit.
7. Kontrata mund të lidhet për një periudhë prej të paktën 1 (Një) dhe më së shumti 4 (katër) vjet – të sezonit garues me pëlqimin e të dyja palëve për një kohë dhe më të gjatë.
8. Kontrata për 1 (një) viti mund të lidhin sportistët të cilët në vitin e nënshkrimit të kontratës janë në moshë 18 vjeçare e më shumë.
9. Me pëlqim të dyanshëm, kontrata mund të shkëputet para skadimit të kohës për të cilën është konstatuar (përfundimi i rënë dakord i kontratës). Ndërprerja e kontratës, e

vërtetuar nga personi i autorizuar i FPSRK-së duhet të bëhet në tre (3) kopje, nga të cilat një (1) i përket klubit amë, Sportistit dhe Komisionit për regjistrim të FPSRK-së.

10. Me kërkesë të Sportistit apo klubit kontrata mund të ndërpritet në mënyrë të njëanshme me vendim të Komisionit për regjistrim të FPSRK-së, në rast që Sportisti apo klubi nuk i përmbush detyrimet e përcaktuara në kontratë dhe aneks.

11. Me kërkesë është e nevojshme të dorëzohen të gjitha dëshmitë relevante që mund të kontribuojë për korrektësinë e vendimit të komisionit për regjistrim të FPSRK-së.

12. Si datë e deponimit të kërkesës, llogaritet data e vulës postare të depozitimit të regjistruar në postë ose data e vërtetimit nga klubi amë.

13. Tema e diskutimit dhe vendimmarrjes së Komisionit për regjistrim të FPSRK-së është vlerësimi i përmbushjes së detyrimeve reciproke në bazë të kontratës në përputhje me këtë rregullore.

14. Komisioni për regjistrim i FPSRK-së është i detyruar të marrë një vendim me shkrim me një shpjegim për palët e interesuara.

Neni 26

1. Klubi i ri në të cilin Sportisti kalon, është i obliguar që të paguajë kompensim për klubin amë nga i cili Sportisti shkon, nëse klubi amë nga i cili Sportisti shkon këtë e kërkon në flet lëshim.

2. Klubi i ri është i obliguar të paguajë kompensim në llogarinë e klubit amë jo më vonë se data e aplikimit të Komisionit për regjistrim i FPSRK-së, brenda kuptimit të nenit 4, paragrafi 3 të kësaj rregulloreje.

3. Bordi i FPSRK-së vendos për shumën maksimale të kompensimit për kategori të caktuara të sportistit. Shuma e kompensimit, si dhe kategorinë e Sportistit Bordi është i obliguar ta publikojë pesëmbëdhjetë (15) ditë para fillimit të periudhës kalimtare ose për një periudhë më të gjatë. Periudha e vlefshmërisë së kompensimit është nga 2 deri në 3 vjet.

4. Nëse vendimi i Komisionit për regjistrim të FPSRK-së, ka pasur një ndërprerje të kontratës në dëm të klubit amë, klubi amë nuk ka të drejtë për kompensim.

5. Nëse vendimi i Komisionit për regjistrim të FPSRK-së, ka pasur një ndërprerje të kontratës në dëm të sportistit, klubi amë përcakton kompensimin i cili përbëhet prej:

5.1. kompensimin maksimal me vendim të Bordit të FPSRK-së si dhe (plus)

5.2. koston reale të klubit amë në relacion me sportistin të bëra deri në momentin e ndërprerjes së kontratës.

6. Në rast të ndërprerjes së njëanshme të kontratës kompensimi përcaktohet me marrëveshje ose sipas paragrafit 2 të këtij neni.

7. Për sportistët të cilët nuk janë nën kontratë dhe të cilëve u ka skaduar kontrata, kompensimi përcaktohet në përputhje me paragrafin 3 të këtij Neni të kësaj rregulloreje.

Neni 27

1. Në qoftë se palët e interesuara konsiderojnë se në procesin e dhënies së fletë lëshimit, me refuzimin e kërkesës për lëshimin e Sportistit nga klubi në klubin janë bërë shkelje të

dispozitive të kësaj rregulloreje mund të ankohet në Komisionin për regjistrim të FPSRK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e pranimit të vendimit.

2. Komisioni për regjistrim i FPSRK-së do të vendos për ankesën brenda tri (3) ditëve nga marrja e ankesës me vendim me shkrim me një shpjegim dhe duhet ta dorëzojë palëve të interesuara.

3. Si datë e deponimit të ankesës, llogaritet data e vulës postare të depozitimit të regjistruar në postë ose data e vërtetimit nga personi zyrtar i FPSRK-së.

4. Në vendim të Komisionit për regjistrim të FPSRK-së palë e pakënaqura mund të ankohet në Bordin e FPSRK-së, si një shkallë më e lartë, brenda pesë (5) ditëve nga pranimi i vendimit.

5. Bordi i FPSRK-së është i obliguar që, brenda 8 (tetë) ditësh nga dita e pranimit të ankesës, të bien një vendim me shkrim me shpjegimin e paraqitur për palët e interesuara.

6. Si datë e deponimit të ankesës, llogaritet data e vulës postare të depozitimit të regjistruar në postë ose data e vërtetimit nga personi zyrtar i FPSRK-së.

7. Vendimi i Bordit të FPSRK-së është përfundimtar.

8. Në rastin e vendimit, Komisioni për regjistrim i FPSRK-së apo Bordi i FPSRK-së, afatin mund përjashtimisht ta lëvizë dhjetë (10) ditë, vetëm për të marrë provat e nevojshme.

Neni 28

1. Gjatë afatit kalimtar, deri në vendimin përfundimtar për miratimin e kërkesës për kalim, Sportisti mund të marrë pjesë në Garat sportit, si anëtarë i klubit amë.

2. Në rastin e kalimit të Sportistit nga klubi në klub, në ditën e marrjes së vendimit të komisionit për regjistrim të FPSRK-së, me miratimin e kërkesës për kalim të Sportistit nga klubi në klub. Sportisti fiton të drejtën të marrë pjesë për klubin e ri.

Neni 29

1. Sportisti, anëtar i klubit të FPSRK-së mundet në përputhje me procedurën e FIPS, të regjistrohet për një klub Sportiv në një shtet tjetër që është anëtar i FIPS, në çdo periudhë të vitit kalendarik.

2. Regjistrimi për një klub të një shteti tjetër Anëtar i FIPS mund të jetë edhe e dyanshme (dyfishtë). Në rastin e regjistrimit të dyanshëm, Sportisti ka të drejtë pjesëmarrjes në gara për klubin në Kosovë në bazë të propozimeve të garave të FPSRK-së.

3. Sportisti i paraqet kërkesë komisionin për regjistrim të FPSRK-së për kalim në klub jashtë vendit.

4. Me kërkesë duhet të dorëzoj edhe:

4.1. pëlqimin e klubit amë për të shkuar jashtë vendit;

4.2. pëlqimi duhet të përmbajë një kërkesë për kaluar me ose pa kompensim;

4.3. pëlqimi në kuptim të regjistrimit të dyfishtë ose jo;

4.4. kërkesën e klubit të huaj dhe miratimi i FIPS klubi i të cilës është anëtarë për kalim të Sportistit.

5. Vendimin për miratimin e kalimit të Sportistit për një klub jashtë vendit e bie Komisioni për regjistrim i FPSRK-së brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga marrja e kërkesës.

6. Sportisti është i detyruar që në kontratë me klubin e huaj të futë edhe dispozitat e mëposhtme:

6.1. që është i obliguar ti përgjigjet ftesës së selektorit të Federatës dhe pa kushte për ekipin kombëtar të Kosovës në të gjitha garat zyrtare;

6.2. se klubi i tij jashtë vendit bartë shpenzimet e ardhjes dhe largimit për ftesat në reprezentacion;

Neni 30

1. Komisioni për garues është i obliguar që ta shqyrtojë dokumentacionin e kompletuar më së largu në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimit, përkatësisht nga dita e kalimit të afatit kalimtar.

2. Klubi, përkatësisht lojtari që nuk e parashtron dokumentacionin e kompletuar duhet të udhëzohet që në afat prej 5 ditësh ta kompletojë atë, në të kundërtën kërkesa do të refuzohet.

Neni 31

Komisioni për regjistrim është i obliguar që pas shqyrtimit të kërkesave për regjistrim, me shkrim ta njoftojë administratën e FPSRK-së në mënyrë që ajo ta bëjë regjistrimin e lojtarëve, si dhe atyre t'ua lëshojë librezat garuese, duke i evidencuar në librin e evidencës.

Neni 32

Formën dhe përmbajtjen e librezës garuese e përcakton me akt të posaçëm Bordi i FPSRK-së

Neni 33

Në qoftë se libreza garuese humbet apo bëhet e pavlefshme, klubi i drejtohet administratës së FPSRK-së për ta lëshuar duplikatin e saj.

IV. KALIMI I GARUSEVE - NDËRRIMI I ANËTARËSISË

A. AFATI KALIMTAR

Neni 34

GARUESI prej klubit në klub mund të kalojë vetëm në afatin kalimtar.

Garuesi pa kontratë apo lojtari me status të lojtarit të lirë prej klubit në klub mund të kalojë edhe jashtë afatit kalimtar deri në përfundimin të KAMPIONATIT në të gjitha konkurrencat të edicionit garues.

Neni 35

Dallojmë afatin e rregullt kalimtar dhe mini-afatin kalimtar.

Neni 36

Afati i rregullt kalimtar është në mes të dy vjetëve garues dhe zgjat 15 ditë.

Fillimi dhe përfundimi i afatit kalimtar caktohet me vendim të posaçëm të Bordit të FPSRK-së.

Neni 37

Afati plotësues kalimtar (mini afati) është në mes të sezonit vjeshtor dhe pranveror të vitit garues dhe zgjat shtatë ditë. Fillimin dhe përfundimin e afatit plotësues kalimtar e cakton me vendim të posaçëm Bordi i FPSRK-së (nuk mund të jetë pas fillimit të kampionatit).

Pas përfundimit të afatit plotësues kalimtar, FPSRK-së është e obliguar që deri më 28 shkurt të dërgojë listat përfundimtare zyrës së FIPS.

B. PROCEDURA E PARAPARË PËR KALIMIN E LOJTARIT PREJ KLUBIT/SHOQATES NË KLUB/SHOQATE

Neni 38

Procedura për kalimin e garuesit prej klubit në klub është:

lojtari paraqet kërkesë me shkrim për lëshimin e fletëçregjistrimit në afatin kalimtar drejtuar klubit anëtar i të cilit është në formë të shkruar me dëshmi për pranimin e saj. Klubi të cilit i është drejtuar garuesi është i obliguar që në kërkesën e shkruar në afat prej 8 ditësh të përgjigjet me sa vijon:

- ta lëshojë fletëçregjistrimin
- të mos e lëshojë fletëçregjistrimin, duke e arsyetuar vendimin e vet me shkrim.

Neni 39

1. Në qoftë se klubi tetë ditë nga dita e marrjes së kërkesës nga ana e garuesit nuk përgjigjet në kërkesë të tij, konsiderohet se lojtari nuk ka pengesë për t'u regjistruar në klub të ri.
2. Në qoftë se klubi përgjigjet me shkrim, duke e refuzuar garuesit, është i obliguar që ta arsyetojë këtë refuzim, duke e udhëzuar garuesit që për këtë t'i bëjë ankesë organit kompetent të FPSRK-së.

Neni 40

1. Në kërkesë të drejtuar me shkrim nga ana e garuesit për dhënien e fletëçregjistrimit klubi është i obliguar që ta pranojë atë në këto raste:
 - a. në qoftë se lojtari e ka paraqitur kërkesën në afat kalimtar;

- b. në qoftë se klubi në të cilin lojtari dëshiron të kalojë e ka paguar kompensimin e paraparë në kontratë në mes të lojtarit dhe klubit nga i cili dëshiron të shkojë;
 - c. në qoftë se e ka paguar kompensimin e paraparë me dispozitat gjegjëse për statusin e sportistëve në Kosovë;
 - d. në qoftë se lojtari nuk ka kurrfarë obligimesh të tjera ndaj klubit.
2. Formën dhe përmbajtjen e fletëçregjistrimit e përcakton bordi i FPSRK-së.
 3. Pas lëshimit të fletëçregjistrimit të vlefshëm klubi në të më nuk mund të bëjë vërejtje.

Neni 41

1. Lojtarët dhe klubet mund të nënshkruajnë kontrata mes veti të cilat nuk mund të jenë më afat me të shkurtër se 6 (gjashtë) muaj dhe më shumë se 4 (katër) vjet).
2. Çdo lojtarë, i cili nuk posedon kontratë të vlefshme llogaritet si lojtarë i lirë dhe mund të ndërrojë klubin në afatin e rregullt kalimtar, apo në mini-afatin plotësues dimëror.
3. Kontrata e nënshkruar për gjashtë muaj vlen deri në mbarimin e stinorit, do të thotë deri në afatin e rregullt apo plotësues, pa marr parasysh se a kanë kaluar 6-të muaj.
4. Kontrata e nënshkruar për 1,2,3 apo 4-vite po ashtu vlen deri në mbarimin e kampionatit, dhe lojtari-ja është e lirë në afatin kalimtar (të rregullt apo plotësues).

Neni 42

1. Nëse vjen deri të fuzionimi (bashkimi) i dy klubeve, para përfundimit të afateve kalimtare të përcaktuara me Rregulloren e FPSRK-së mbi regjistrimin e klubeve dhe lojtarëve, klubi i ri e merrë (zënë) vendin në shkallën (rangun) më të lartë garave, në të cilin ka marrë pjesë njëri prej klubeve të fuzionuara (bashkuara), ndërsa lojtarët e të dy klubeve kanë të drejt të lojës për klubin e ri.
2. Nëse ky fuzionim është bërë pas afatit kalimtar sipas Rregullores së FPSRK-së mbi regjistrimin e lojtarëve, klubi ri e zë vendin në rangun më të lartë të garave, në të cilin ka marrë pjesë njëri prej klubeve të fuzionuara, ndërsa në lojëra për klubin e ri kanë të drejt të paraqiten vetëm lojtarët klubit e rangut më të lartë të garave, ndërsa lojtarët e klubit tjetër këtë të drejt e fitojnë vetëm në afatin tjetër kalimtar.

Neni 43

1. Nëse vjen deri te shuarja e ndonjë klubi gjatë garave, ai klub fshihet nga regjistri i FPSRK-së, kurse lojtarët kanë të drejt të regjistrohen vetëm në afatin kalimtar.
2. Nëse klubi shuhet para fillimit të garave për sezonin e ri, lojtarët kanë të drejt të regjistrohen për klubin e ri edhe jashtë afatit kalimtar, sepse nuk janë fajtor për rrethanat e reja të krijuara në gara, dhe fitojnë të drejtën e lojës 8 ditë pas fletëparaqitjes për regjistrim.

Neni 44

Klubi nga i cili kërkohet fletëçregjistrimi ka të drejtë për kompensim nga klubi në të cilin dëshiron të kalojë lojtari, nëse më parë me atë lojtar ka pasur kontratë të vlefshme, ku është

cekur edhe kompensimi për të në rastet e kalimit të lojtarit në ndonjë klub tjetër. Kompensimi mund të rregullohet me marrëveshje dhe nëse klubi dhe lojtari kanë pasur kontratë të vlefshme.

C. KUNDËRSHTIM PËR MOSLËSHIMIN E FLETËÇREGJISTRIMIT

Neni 45

1. Në qoftë se klubi të cilit i është drejtuar lojtari për fletëçregjistrim përgjigjet negativisht apo në qoftë se klubet nuk mund të merren vesh për kushtet e kalimit të lojtarit, mund t'i paraqitet kundërshtim Komisionit për regjistrim.
2. Bashkëngjitur kundërshtimit paraqitet edhe:
 - a. kopja e kërkesës së garuesit për lëshimin e fletëçregjistrimit, duke e dokumentuar atë me kohë dhe datën kur është bërë kjo kërkesë,
 - b. kopja e përgjigjes negative nga klubi,
 - c. vërtetimi mbi pagesën e bërë prej 20 euro në xhirollogarinë gjegjëse të FPSRK-së në emër të kundërshtimit të bërë.

Neni 46

Komisioni për regjistrim duhet të vendosë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së kundërshtimit, duke e njoftuar palën me shkrim me vendimin e këtij organi të bazuar në akte normative të FPSRK-së.

D. ANKESA NË VENDIMIN E KOMISIONIT PËR REGJISTRIM

Neni 47

1. Në vendimin e Komisionit për regjistrim, si organ të shkallës së parë pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 8 ditësh nga dita e marrjes së vendimit.
2. Ankesa parashtrohet në administratën e FPSRK-së për komisionin e shkallës së dytë - Komisioni arbitrar (ky komision i ka tre anëtarë, të cilët i zgjedh bordi i FPSRK-së).
3. Ankesës i bashkëngjitet edhe vërtetimi mbi pagesën e bërë prej 50 euro në xhirollogarinë gjegjëse të FPSRK-së.
4. Komisioni arbitrar është i obliguar që të vendosë lidhur me këtë ankese në afat prej 15 ditësh. Vendimi i komisionit arbitrar është i prerë.

V. E DREJTA NË PARAQITJE GARË

Neni 48

1. garuesi ka të drejtë paraqitjeje – loje menjëherë pas regjistrimit:
 - në qoftë se është i regjistruar për herë të parë,
 - në qoftë se është i regjistruar në afatin kalimtar.

2. garuesit ka të drejtë paraqitjeje – loje (8) tetë ditë pas regjistrimit në rastet si vijojnë:
 - në qoftë se është i regjistruar me vendim të organit kompetent të FPSRK-së,
 - në qoftë se deri në ditën e regjistrimit nuk ka luajtur më shumë se një vit dhe nuk ka qenë i lidhur me kontratë me ish-klubin e tij.
 - në qoftë se është regjistruar edhe jashtë afatit kalimtar deri në përfundimin e javës së 5-të të Kampionatin në të gjitha konkurrencat, por me pëlqimin e klubit amë.

Neni 49

Garuesi nuk ka drejtë loje gjatë mbajtjes se dënimit nga organi kompetent i FPSRK-së .

Neni 50

Për klubet e të Kosovës kanë të drejtë të regjistrohen numër i pakufizuar i garuesve nënshtetas të huaj të regjistruar në bazë të kësaj rregulloreje, mirëpo të drejtë paraqitje në një ndeshje kanë më së shumti 3 lojtarë (në procesverbal të një ndeshjeje).

Neni 51

Në ndeshje miqësore lojtari mund të paraqitet për ekipin për të cilin nuk është i regjistruar me leje të klubit amë.

VI. KONTRATAT NË MES TË KLUBEVE DHE LOJTARËVE

Neni 52

Të drejtat dhe obligimet si dhe marrëdhëniet e tjera reciproke në mes të klubeve dhe garuseve rregullohen me kontratë, e cila duhet të lidhet më së paku me kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj e deri më së shumti 4 (katër) vjet.

GARUESIT - E PA KONTRATË

Neni 53

1. GARUESIT të cilët nuk kanë kontratë me shkrim me ekipet – klubet e tyre dhe të cilëve nuk iu është paguar kompensimi mbi dhe më tepër e shpenzimeve të nevojshme dhe të domosdoshme për paraqitje në lojë, konsiderohen – trajtohen si lojtarë pa kontratë.
2. Shpenzimet e nevojshme dhe të domosdoshme të cilat lojtari mund ti merr duke mos rrezikuar statusin e vet si lojtarë pa kontratë janë:
 - a. shpenzimet e udhëtimit;
 - b. shpenzimet e vendosjes;
 - c. Paisjet sportive;
 - d. participimi për ushtrime.
3. garuesit /ja pa kontratë është i lire dhe në qdo kohë mund të kalon në ndonjë ekip klub tjetër pa ndonjë kusht të veçantë.

GARUESI ME KONTRATË

Neni 54

1. Garuesit të cilët janë paguar më shumë se kompensimet sipas Rregulloreje duhet të kenë kontratë me ekipin – klubin e tyre. Këta lojtarë konsiderohen – trajtohen si lojtarë me kontratë.
2. Ekipet – klubet janë të obliguara të dorëzojnë në Federatë formularin nr. B (statusin e lojtarëve). FRK-ja duhet të përpilojë regjistrin qëndror të lojtarëve nën kontratë dhe çdo vit deri më 15 janar të njëjtin t'ia përcjellë _____ Euorpe në fotokopje – regjistrim komplet.

KONTRATAT

Neni 55

Lojtari dhe ekipi-klubi mund të lidhin një nga këto dy llojet e kontratave:

1. Kontratë mbi perfeksionimin sportiv dhe stipendim
2. Kontratë mbi luarje si veprimtari shtesë (kontratë amatore)
3. Kontratë për paraqitje – luajtje si profesionist

Neni 56

1. Kontrata duhet të përmbajë të drejtat dhe obligimet e të dy palëve, dhe të njëjtës duhet ti përcaktohet afati i zgjatjes, i cili nuk mund të jetë më i shkurtër se 6-të muaj, dhe as më i gjatë se 4-të vjet.
2. Kontratat e cila nënshkruhet për 6-të muaj. Vlen deri në afatin kalimtar (të rregullt apo plotësues) pa marrë parasysh datën e nënshkrimit, sepse ajo vlen prej një afati kalimtar deri në afatin tjetër kalimtar. Kontratat e nënshkruara me afate 1 vjeçare, dy vjeçare, tre vjeçare apo 4 vjeçare me mbarimin e sezonit për sa vite ka nënshkruar lojtari, ai është i lire me fillimin e afatit kalimtar (të rregulltë apo plotësues)

a). KONTRATA MBI PREFIKSIONIMIN SPORTIV DHE STIPENDIM

Kontrata për lojtarë mbi perfeksionimin sportiv dhe stipendim përmban:

- dispozitat mbi obligimet e ekipit-klubit lidhur me banimin, ushqimin, transportin lokal, sigurimin shpërblimet dhe kompensimet
- dispozitat lidhur me obligimet e lojtarit lidhur me ushtrimet dhe ndeshjet
- dispozitat lidhur me kohëzgjatjen e kontratës
- dispozitat mbi obligimin e lojtarit, lidhur me nënshkrimin e kontratës profesionale apo kontratës mbi lujtje si veprimtari shtesë
- dispozitat mbi kompensimin për kalim në ekip-klub tjetër vendor apo të jashtëm para kalimit të kontratës

b). KONTRATA PËR AMATORE

Neni 57

Ekipet – klubet dhe lojtarët-et e regjistruar për ta të cilët përveç garuesit ushtrojnë edhe ndonjë veprimtari tjetër plotësuese, mund të lidhin kontratë në mes tyre për luajtje të garuesit si amatorë.

Neni 58

Kontrata për Ekipet –klubet dhe lojtarët-et e regjistruar të cilët përveç garuesit ushtrojnë edhe ndonjë veprimtari tjetër plotësuese, mund të lidhin kontratë në mes tyre për luajtje si lojtarë amatorë përmban:

- dispozitat mbi obligimet e ekipit-klubit lidhur me banimin, ushqimin, transportin lokal, sigurimin shpërblimet dhe kompensimet
- dispozitat lidhur me obligimet e lojtarit lidhur me ushtrimet dhe ndeshjet
- dispozitat lidhur me kohëzgjatjen e kontratës
- dispozitat mbi obligimin e lojtarit, lidhur me nënshkrimin e kontratës profesionale
- dispozitat mbi kompensimin për kalim në ekip-klub tjetër vendor apo të jashtëm para kalimit të kontratës.

Neni 59

1. Kontrata si lojtarë amatorë nuk mund të lidhin lojtarët më të rinjë se 18-të vjet. Kjo kontratë mund të lidhet të nënshkruhet në kohëzgjatje prej 6-të muaj deri në 2 apo 4 vjet.
2. E njëjta mund të shkëputet me marrëveshje para kalimit të afatit në dobi të nënshkrimit të kontratës profesionale.

c). KONTRATA PROFESIONALE

Neni 60

Lojtarë profesional trajtohen ata lojtarë, të cilët ekzistencën e vet e sigurojnë duke garuar në peshkim.

Neni 61

Ekipi dhe lojtari janë të lirë me rastin e nënshkrimit të kontratës profesionale, me të cilën rregullohen dhe obligimet ndërmjet tyre.

Neni 62

Kontrata profesionale e nënshkruar në mes ekipit dhe lojtarit përmban posaçërisht:

- të drejtat dhe obligimet e ekipit
- të drejtat dhe obligimet e garuesit
- dispozitat lidhur me sigurimin shëndetësor, pensional dhe invalidor
- dispozitat lidhur me kohëzgjatjen e marrëdhënieve kontraktuese
- dispozitat lidhur me kushtet e shkëputjes së kontratës
- dispozitat lidhur me kompensimin –dëmshpërblimin për kalim në ekip tjetër vendas apo të jashtëm pas kalimit të kontratës
- dispozitat me të cilat parashihet shkëputja e kontratës në rastet e mos përmbushjes së kushteve të saj
- dispozitet rrethë kushteve financiare

Neni 63

Kontratë profesionale nuk mund të nënshkruajnë lojtarët më të rinjë se 18-të vjet

Neni 64

Kontratat mund të nënshkruhen në afat prej 6 muaj deri në 2 – 4 vjet (apo zgjidhje më e përshtatshme në mes ekipit dhe lojtarit)

Neni 65

1. Pas kalimit të kontratës profesionale, lojtari është i lirë në zgjedhjen e ekipit.

2. Për lojtarin të cilit i ka kaluar-skaduar kontrata, ekipi ka të drejt në kompensim-dëmshpërblim nga ekipi i ri deri në lartësinë e shumës së përcaktuar në kontratë, apo sipas kriteriumeve për dëmshpërblim të parapara në këtë Rregullore.

Neni 66

Pas kalimit të kontratës, lojtari me kontratë e fiton statutin e lojtarit pa kontratë – lojtarit të lirë. Në rast të kalimit të lojtarit (tani lojtar pa kontratë) në ekip tjetër, ekipi prej të cilit shkon nuk ka të drejt në kompensim, përveç në rastet kur kemi të bëjmë me precizimin e marrëdhënieve në kontratë apo tek lojtarët nën moshën 23 vjeçare.

Neni 67

1. Përjashtimet nga neni paraprak janë të mundëshme:

- Nëse ish lojtari nën kontratë, nënshkruan kontratë të re në afat prej (12) dymbëdhjetë muajve nga skadimi – kalimi i kontratës së vjetër, dhe regjistrohet si lojtar nën kontratë konformë me dispozitat e Rregullores mbi statusin e lojtarit, ekipi i cili i fundit e ka pasur atë lojtar nën kontratë ka të drejt në kompensim-dëmshpërblim. Shuma e kompensimit (dëmshpërblimit) është përcaktuar me kontratën e fundit ose sipas kriterëve për dëmshpërblim konformë me dispozitat e Rregullores mbi statusin e lojtarëve.

Neni 68

Nëse ekipi i cili i fundit e ka pasur lojtarin nën kontratë dyshon në statutin e atij lojtari në ekipin e ri mund të kërkojë nga Federata e organeve përkatëse, sqarime konkrete dhe ndërmarrjen e masave të duhura.

c) UDHËHEQJA, EVIDENCA E KONTRATAVE DHE KONTESTET

Neni 69

1. Statusin e lojtarit e udhëheq, evidenton dhe vërteton Komisioni për regjistrim pranë FRK-së, në formularin nr. 4 në afat prej 8 ditëve nga dita e nënshkrimit.
2. Formulari nr.4 plotësohet në 3 ekzemplar – kopje të cilët i përcillen Komisionit për regjistrim në vërtetim, pastaj nga një ekzemplar (kopje) mbetet në dokumentacionin e FPSRK-së.
3. Kontratat të cilat nuk janë të regjistruara dhe evidentuara në regjistrin e Federatës së garuesit të Kosovës, nuk prodhojnë efekte të cilat Komisioni i garave – Komisioni i garave do të merrte parasysh.

Neni 70

1. Në çoftëse njëra nga palët kontraktuese mendon se pala tjetër nuk iu ka përmbajtur klauzulave qenësore të kontratës, mund të kërkoj shkëputjen e kontratës nga Komisioni për regjistrim i FPSRK-së.
2. Lojtari apo ekipi i cili kërkon shkëputjen e kontratës duhet të paraqet:
 - Kërkesën për shkëputjen e kontratës të argumentuar me prova bindëse
 - Kopjen e kontratës
 - Vërtetimin mbi pagesën e shumës prej 50€ në llogari rrjedhëse të FPSRK-së .

Neni 71

Mbi kërkesën për shkëputjen e kontratës Komisioni për regjistrim i FPSRK-së, duhet të vendos në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të kërkesës.

Në vendimin e Komisionit për regjistrim, pala e pakënaqur ka të drejt ankese. Ankesa i paraqitet Komisionit arbitrar të FPSRK-së, në afat prej 8 ditëve nga marrja e vendimit, me pagesë të shumës prej 50 €.

Vendimi i Komisionit arbitrar është përfundimtar dhe ndaj tij nuk lejohet ankesa.

VII. KATEGORIZIMI GARUSEVE

Neni 72

Lojtarët janë të kategorizuar si vijon:

1. Garues i kategorisë kombëtare senior (zgjat një vjet nga dita e fitimit të statutit) lojtar të kësaj kategorie janë të gjithë ata lojtar, të cilët luajnë për kombëtare ndeshje në lojërat olimpike, kampionate botërore dhe evropiane, si dhe miqësore, me kusht që të jenë në listen e përzgjedhësit për tërë atë vit garues.
2. garuesit i kategorisë së juniorëve (zgjat një vjet nga dita e fitimit të statusit) lojtar të kësaj kategorie janë të gjithë ata lojtar që luajnë për kombëtare në gara zyrtare të kombëtares sonë, apo edhe lojëra miqësore ndërkombëtare gjate një viti, dhe gjenden në listën e përzgjedhësit të kombëtares.
3. garuesit i kategorisë pionier (zgjat një vjet nga dita e fitimit të statusit)
 - lojtar të kësaj kategorie janë të gjithë ata lojtar që luajnë për kombëtare në gara zyrtare të kombëtares sonë, apo edhe lojëra miqësore ndërkombëtare gjat një viti, dhe gjenden në listën e përzgjedhësit të kombëtares.
4. Lojtarë të regjistruar konform dispozitave të kësaj Rregulloreje

VIII. E DREJTA E KALIMIT TË GARUESIT NGA EKIPI NË EKIP TË CILAT GAROJNË NË KUADËR TË FPSRK-së

Neni 73

Kalimi i garuesit në ekip tjetër bëhet gjatë afatit kalimtar në çoftëse:

- lojtari e ka fletë çregjistrimin e ekipit anëtar i së cilës ka qenë deri tani,
- lojtari e ka vendimin e plotfuqishëm të Bordit të FPSRK-së mbi të drejtën e regjistrimit për ekip tjetër
- nëse është lojtar pa kontratë

IX. DËMËSHPËRBLIMI – KOMPENZIMI

DËMËSHPËRBLIMI – KOMPENZIMI PËR KALIMIN E GARUESIT NGA EKIPI NË EKIP TË CILAT GAROJNË NË KUADËR TË FPSRK-së

Neni 74

Për kalimin e lojtarit nga ekipi në ekip, të cilat garojnë në kuadër të FPSRK-së, ekipi anëtar i të cilit ka qenë lojtari nën kontratë ka të drejt në dëmshpërblim – kompensim.

Dëmshpërblimi – kompensimi në bazë të kontratës ekipi – lojtari.

Neni 75

Për lojtarët më të ri se moshë 23-vjeçare, të cilët kanë kontratë valide apo janë lojtarë të lirë, duhet të paguhet dëmshpërblimi – kompensimi sipas nenit 65 të kësaj Rregulloreje.

Neni 76

Shuma më e vogël e dëmshpërblimit – kompensimit, për kalimin e lojtarit nga ekipi në ekip të cilat garojnë në kuadër të FPSRK-së, përcaktohet në bazë të kategorizimit të lojtarëve, totali i poenëve – pikëve i shumëzuar me vlerën e poenit – pikës të cilën e përcakton Bordi i FPSRK-së para afatit kalimtar duke patur parasysh këto kritere:

1. Vitet e kaluar në ekip deri në moshën 16-të vjeçare

			Femrat
	1 poen – pike	për sezon garues	
Meshkujt	1 poen – pike	për sezon garues	

2. Vitet e kaluara në ekip deri në moshën 18-të vjeçare

Femra	1,5 poen – pikë	për sezon garues
Meshkujt	2 poen - pikë	për sezon garues

3. Vitet e kaluara në ekip mbi moshën 18 vjeçare

Femrat	2 poen – pikë	për sezon garues
Meshkujt	4 poen – pikë	për sezon garues

4. Sipas kategorizimit të lojtarëve në kuadër të FPSRK-së

Femrat	4 poen –pikë	sportist i kategorisë botërore
Meshkujt	5 poen – pikë	sportist i kategorisë botërore
Femrat	3 poen – pikë	sportist i kategorisë ndërkombëtare
Meshkujt	4 poen - pikë	sportist i kategorisë ndërkombëtare
Femrat	2 poen –pikë	sportist i kategorisë kombëtare
Meshkujt	3 poen –pikë	sportist i kategorisë kombëtare
Femrat	1 poen –pikë	sportist i kategorisë junior
Meshkujt	2 poen –pikë	sportist i kategorisë junior
Femrat	1 poen –pikë	sportist i kategorisë kadet
Meshkujt	2 poen –pikë	sportist i kategorisë kadet
Femrat	0,5 poen – pikë	sportist lojtarë
Meshkujt	1 poen – pikë	sportist lojtarë

5. Sipas numrit të titujëve të fituar

Femrat	4 poen – pikë	Kampion i Kosovës në
Meshkujt	5 poen - pikë	Kampion i Kosovës në
Femrat	3 poen – pikë	Fitues i Kupës së Kosovës
Meshkujt	4 poen – pikë	Fitues i Kupës së Kosovës
Femrat	2 poen – pikë	Kampion i Kampionatit - Senior -
Meshkujt	3 poen – pikë	Kampion i Kampionatit - -
Femrat	1 poen – pikë	Kampion i Ligës së junioreve të Kosovës
Meshkujt	2 poen – pikë	Kampion i Ligës së juniorëve të Kosovës
Femrat	0,5 poen – pikë	Kampion i Ligës së kadeteve të Kosovës
Meshkujt	1 poen – pikë	Kampion i Ligës së kadeteve të Kosovës

6. Sipas numrit të paraqitjes në përfaqësuesen e Kosovës (vetëm garat zyrtare, kampionatet botërore, evropiane, lojërat olimpike, dhe garat tjera.

Femrat	0,20 poen – pikë	për garë në përfaqësuesen e senioreve
Meshkujt	0,25 poen – pikë	për garë në përfaqësuesen e seniorëve
Femrat	0,15 poen – pikë	për garë në përfaqësuesen e junioreve
Meshkujt	0,20 poen – pikë	për garë në përfaqësuesen e juniorëve
Femrat	0,10 poen – pikë	për garë në përfaqësuesen e pioniereve
Meshkujt	0,15 poen – pikë	për garë në përfaqësuesen e pioniereve

Vlera e poenit është 50 euro sipas Vendimit të Bordit nga mbledhja e mbajtur më pas përfundimit të sezonit.

Neni 77

Nga shuma e arkëtuar e dëmshpërblimit – kompensimit, për kalimin e lojtarit , ekipi është i obliguar që 20% të kësaj shume të paguaj në konton e Federatës .

Neni 78

Interpretimin e këtyre kritereve e bënë Bordi i Federatës -së në bashkëpunim me Komisionin arbitrar të Federatës .

D). DËMSPËRBLIMI – KOMPENZIMI PËR KALIMIN E LOJTARIT NGA EKIPI ANËTAR I FPSRK-së NË EKIPIN E FEDERATËS TJETËR TË PRANUAR

Neni 79

1. Dëmshpërblimi – kompensimi për kalimin e garuesit në klub të Federatës tjetër të garuesit të pranuar nën klubin Evropian dhe FPSRK-së, përcaktohet në bazë të kontratës lojtar – ekip.
2. Nëse nuk ekziston kontrata në mes lojtarit dhe ekipit, ekipi nuk ka të drejt në dëmshpërblim - kompensim.
3. Përjashtim bënë rasti kur kemi të bëjmë lojtarët nën moshën 23 vjeçare të cilët duhet të paguajnë dëmshpërblimin – kompensimin komfor nenit 70 të kësaj rregulloreje.

C). LEJA PËR REGJISTRIM DHE PARAQITJA NË EKIPIN E FEDERATËS TJETËR NACIONALE

Neni 80

Garuesi me kontratë mund të fiton lejen për lojë në ekipin e Federatës tjetër nacionale:

- nëse e ka fletë çregjistrimin e ekipit anëtarë i të cilit ka qenë deri atëherë
- nëse e ka paguar Certifikatën ndërkombëtar të transferit
- nëse e ka fletë çregjistrimin e Federatës anëtar i të cilës ka qenë apo është ekipi
- nëse e ka lejen e Bordit të FPSRK-së (për ata lojtarë të cilët janë kandidat për ndonjë seleksion të përfaqësueses së Kosovës, regjistrin të cilin në çdo vit kalendarik e dorëzon përzgjedhësi i kombëtares)
- nëse ekipi i huaj ka nënshkruar marrëveshje me FPSRK-së, me të cilën obligohet që garuesit gjegjësisht do të jetë në dispozicion të përfaqësueses sonë kombëtare në të gjitha lojërat zyrtare (si dhe përgatitjet rreth këtyre lojërave)
- nëse e ka paguar kompensimin – dëmshpërblimin ndaj klubit sipas marrëveshjes në kontratë
- nëse e ka fletë ç regjistrimin e Federatës anëtar i të cilës ka qenë apo është ekipi

Neni 81

1. GARUESI me kontratë i cili është më i ri se mosha 20 vjet mund të regjistrohet për ekipin e Federatës tjetër nacionale në çoftëse paraprakisht i plotëson të gjitha obligimet ndaj klubit me të cilin ka pasur kontratë me këto kushte:
 - nëse e ka paguar kompensimin ndaj klubit në shumë prej 15 € për edicion të garave, në bazë të paraqitjeve në atë klub dhe i llogariten vitet e kaluara
 - nëse ka paguar kompensimin ndaj FPSRK-së në shumë prej 15 € për një vit si garues i përfaqësueses së Kosovës, dhe i llogariten të gjitha vitet sa ka qenë anëtarë i përfaqësueses së Kosovës
 - nëse e ka paguar Certifikatën ndërkombëtar të transferit

D). TAKSA PËR SHITETAS TË HUAJ TË CILËT DËSHIROJNË TA FITOJNË TË DREJTËN E KALIMIT NGA EKIPET ANËTARE TË FPSRK-së, NË EKIPET E FEDERATAVE TË JASHTME

Neni 82

Lojtari shtetas i huaj për fitimin e të drejtës së kalimit prej ekipit anëtarë i **FPSRK-së**, -së në ekipin e Federatës së jashtme duhet të paguaj në konton e **FPSRK-së**, shumën prej 100 € sipas rregullave ndërkombëtare të.

Neni 83

Rreth kundërshtimeve dhe kontesteve të palëve, në shkallë të parë vendos Komisioni për regjistrim, ndërsa në shkallë të dytë Komisioni arbitrar i FPSRK-së, vendimi i të cilit është definitiv.

Neni 84

Të gjitha klubet në të gjitha kategoritë dhe konkurrencat mund të lidhin njëërën prej formave të kontratave të cekura nën paragraf, të cilat duhet të vërtetohen dhe të evidencohen në organin e FPSRK-së.

Neni 85

1. Në qoftë se njëra prej palëve kontraktuese nuk i plotëson kushtet e kontratës, pala e dëmtuar ka të drejtë të kërkojë shkëputjen e kontratës para afatit.
2. Kërkesa për shkëputjen e kontratës i paraqitet Komisionit për regjistrim, i cili për këtë duhet të vendosë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së kërkesës.
3. Kërkesës për shkëputjen e kontratës duhet bashkëngjitur edhe vërtetimin mbi pagesën e 15 eurove në xhirollogarinë gjegjëse të FPSRK-së.

Neni 86

1. Në vendimin e Komisionit për regjistrim pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimi Komisionit arbitrar.
2. Ankesës duhet bashkëngjitur vërtetimin mbi pagesën e bërë prej 15 euro në xhirollogarinë gjegjëse të FPSRK-së.
3. Vendimi i Komisionit arbitrar është i prerë.

Neni 87

Kontrata që është në kundërshtim me dispozitat e ligjit për sport në Kosovë, si dhe akteve të tjera të FPSRK-së është e pavlefshme.

X. HUAZIMI I GARUSEVE

Neni 88

1. Klubi ka të drejtë t'ia huazojë **garuesin** e vet klubit tjetër.
2. Huazimi i lojtarit bëhet me pëlqimin e tij, në mes të dy klubeve të interesuara për një kohë të caktuar e më së paku (6) muaj dhe kjo rregullohet me kontratë të posaçme në mes të klubeve dhe lojtarit.
3. Lojtari i cili huazohet në klubin tjetër nuk mund të ketë kontratë me klubin e rinjë, por i vazhdon kontrata me klubin amë, dhe koha e kaluar në klubin e ri i llogaritet si anëtar i klubit amë.

Neni 89

1. Lojtari mund të huazohet në afatin e rregullt kalimtar, apo deri në përfundimin e mini afatit kalimtar.
2. Pas përfundimit të mini afatit kalimtar nuk lejohet huazimi.
3. Për lojtarin e huazuar klubi i interesuar duhet të paraqesë këtë dokumentacion (Formulari nr.9):
 - a. kontratën mbi huazimin e garuesit , të nënshkruar dhe vërtetuar nga dy klubet si dhe pëlqimin me shkrim të garuesit për huazim,
 - b. dy fotografi të madhësisë 3x4 cm, jo më të vjetra se gjashtë muaj, vërtetimin mbi pagesën e bërë prej 100 euro në xhirollogarinë gjegjëse të FPSRK-së.

XI. KALIMI I LOJTARËVE NË KLUBE TË BOTËS SË JASHTME

Neni 90

Garuesit kosovarë kanë të drejtë kalimi në klube të botës së jashtme në bazë të dispozitave pozitive ekzistuese të , si dhe akteve ndërkombëtare .

Neni 91

Për kalimin dhe fitimin e së drejtës në garimit- paraqitje për ekipe të klubeve të botës së jashtme çdo lojtar kosovar është i obliguar ta kërkojë International Transfer Certificate nga FPSRK-së duke paguar shumën prej 100€ euro në xhirollogarinë gjegjëse të FPSRK-së .

XII. KALIMI DHE REGJISTRIMI I LOJTARËVE NGA KLUBET E BOTËS SË JASHTME NË KLUBET KOSOVARE

Neni 92

1. Garuesi me nënshtetësi të huaj apo me nënshtetësi të dyfishtë mund të regjistrohet në çdo klub anëtar i FPSRK-së me procedurë të paraparë sipas akteve ndërkombëtare të garuesit.
2. Për një klub sipas alinesë paraprake gjatë një viti garues mund të regjistrohen numër i pakufizuar i lojtarëve, mirëpo të drejtë paraqitje në lojë në një ndeshje kanë të dejtë më së shumti 6 lojtarë-e (të cilët shënohen në procesverbal).

Neni 93

1. Për garues nënshtetas të jashtëm, i cili kalon nga ndonjë klub i jashtëm në klub kosovar, Komisionit për regjistrim duhet parashtruar këtë dokumentacion:
 - a. fletëkërkesën e lojtarit me kërkesë të klubit për regjistrim në formë të shkruar në dy kopje (formulari nr.C);
 - a. Certifikatën ndërkombëtare të kërkuar nga klubi përmes formularit nr 10;
 - b. dy fotografi të madhësisë 3x4 cm, jo më të vjetra se gjashtë muaj;
 - c. vërtetimin mbi pagesën e bërë prej 30 euro për regjistrim;

- d. vërtetimin mbi pagesën e bërë prej 100 euro në xhirollogarinë gjegjëse të FRK-së për lojtarë që vijnë nga klubet e jashtme.

Neni 94

Lojtarët më nënshtetësi të huaj apo me nënshtetësi të dyfisht mund të regjistrohet në çdo klub anëtar i **FPSRK-së**, me procedurë të paraparë sipas akteve normative të FPSRK-së dhe atyre ndërkombëtare, lojtarët me nënshtetësi të huaj apo me nënshtetësi të dyfisht mund të regjistrohen:

- gjatë afatit kalimtarë të rregullt;
- gjatë mini-afatit kalimtar; dhe
- dhe deri në përfundimin e afatit të paraqitjes së Listave në zyrën e EGA-së (data e fundit gushtit)

XIII. REGJISTRIMI I TRAJNERËVE, GJYQTARËVE, KONTROLLUESVE DHE PERSONAVE TË TJERË ZYRTARË TË FPSRK-së,

Neni 95

Anëtar i FPSRK-së në cilësinë e trajnerit mund të bëhet çdo person që regjistrohet në administratën e FPSRK-së në librin gjegjës nën kushtet e parapara me aktet normative të FPSRK-së dhe Rregulloresë mbi licencim të Shoqatës së trajnerëve.

Neni 96

Librin e evidencës së trajnerëve e mban administrata e FPSRK-së nën kushtet e parapara me statut të Shoqatës së trajnerëve.

Neni 97

Anëtar i FPSRK-së në cilësinë e gjyqtarit dhe të kontrolluesve mund të bëhet çdo person që e ka provimin e dhënë për kategoritë gjegjëse të parapara me Rregullore ndërkombëtare të garuesit, me statutin e Shoqatës së gjyqtarëve dhe kontrolluesve dhe me aktet e tjera të FPSRK-së .

Neni 98

Librin e evidencës së gjyqtarëve dhe kontrolluesve e mban administrata e FPSRK-së nën kushte e parapara me status të Shoqatës së gjyqtarëve dhe të kontrolluesve.

Neni 99

Neni 104

1. Kunder Vendimit të Bordit të FPSRK-së lidhur me regjistrimin e lojtarit, pala e pakënaqur ka të drejtë të parashtojë ankesë Gjykatës Kompetente.
2. Nderkaq për mosmarrëveshjet klub – garues dhe anasjelltas, të cilat nuk mund t'i zgjidhin organet e FPSRK-së, apo ne rastet kur vendimet e tyre njera palë është e pakënaqur, kompetente është Gjykata e cila autorizohet në kontratën e lidhur ndermjet klubit dhe garuesit (potencimi i gjykatës së autorizuar në kontratë është i obligueshëm).

Personat e tjerë, vëzhguesit, kryetarët e klubeve, përfaqësuesit zyrtarë të klubeve, mjeku i klubit e të tjerë janë persona që me dëshirë të veten bëhen anëtarë të klubeve dhe regjistrohen në kushtet e parapara në këtë rregullore dhe aktet normative të tjera të **FPSRK-së**, në librin për regjistrimin e personave të tjerë.

Neni 100

1. Librin mbi evidencën e personave të tjerë e mban administrata e FPSRK-së nën kushtet e parapara me aktet normative të FPSRK-së .
2. Regjistrimin sipas nenit paraprak për personat e tjerë e bën Komisioni për regjistrim, të cilit duhet bashkëngjitur këtë dokumentacion:
 - a. kërkesën e klubit me shkrim për regjistrim të anëtarit të klubit në cilësinë e anëtarit, të shtypur në dy kopje;
 - b. një fotografi të madhësisë 3x4 cm;
 - c. vërtetimi mbi pagesën e bërë prej 15 euro në xhirollogarinë gjegjëse ose në arkën e FRK-së.

XIV. LIBRI I EVIDENCËS DHE UDHËHEQJA E TIJ

Neni 101

1. Në bazë të dispozitave të kësaj rregulloreje Komisioni për regjistrim i mban këto libra të evidencës:
 - a. libri i evidencës së garuesëve;
 - b. libri i evidencës së trajnerëve;
 - c. libri i evidencës së gjyqtarëve dhe kontrolluesve dhe libri i evidencës së personave të tjerë të FPSRK-së.

Neni 102

1. Në librat e evidencës të cekura nga neni paraprak medoemos duhet të jenë këto shënime:
 - a. numri rendor;
 - b. numri amë i garuesit, trajnerit, gjyqtarit, kontrolluesit apo personit tjetër, emri, emri i prindit dhe mbiemri, data, muaji, viti dhe vendi i lindjes;
 - c. data kur e fiton të drejtën në gare, paraqitje, kalimet prej klubit në klub, data e çregjistrimit nga libri i evidencës dhe rubrika për regjistrimit vjetor.

Neni 103

FRK-së Librat e evidencës të cekura më lart mbahen në evidencë të administratës së dhe mund t'i udhëheqin shoqatat gjegjëse.

XV. MBROJTJA E RREGULLORES

XVI. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 105

1. Dispozitat e kësaj rregulloreje i interpreton Bordi i FPSRK-së.

Neni 106

Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj rregulloreje bëhen me procedurë të paraparë për miratimin e saj.

Neni 107 Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi, shtatë (7) ditë pas nënshkrimit nga Kryetari i **Federatës së Peshkatarëve Sportiv Rekreativ e Kosovës** dhe publikimit në faqen zyrtare të FPSRK-së .

Milaim Vitia

Federata e Peshkatarëve Sportiv Rekreativ e Kosovës

